



Partizani është kualifikuar për në turin e tretë eliminator të Ligës së Kampioneve. Partizani ka arritur të barazojë me rezultatin 1-1 në ndeshjen e dytë kundër ekipit kampion të Hungarisë, Ferencvárosit. Takimi i parë i luajtur në Elbasan Arena ka përfunduar me rezultatin 1-1, dhe me të njëjtat shifra ka përfunduar edhe ndeshja e sotme. Ferencvárosi ka kaluar i pari në avantazh me anë të Gera në minutën e 11 me anë të një penalltie. Në minutën e 40 ka ardhur goli i barazimit për ekipin shqiptar të Partizanit. Kundërsulm i Partizanit, Ibrahimit ka dhënë një kros në zonë, ku ka nderhyrë mbrojtësi Husing duke dërguar topin në portën e Ferencvárosit. Rezultati ka ngelur i pandryshuar në 120 minutat e lojës të rregullt. Portieri i Partizanit Hoxha ka filluar serinë e penalltive duke bërë një supergjuajtje alla "Paneka". Me pas ai ka qenë serish protagonist duke pritur penalltinë e gjuajtur nga Gera. Me pas ka qenë Vila ai që ka gjuar por serish Hoxha ka pritur penalltinë e gjuajtur nga Sestak. Me pas Trashit ka shënuar penalltinë, rezultati 0-2 për Partizanin. Nagi ka shënuar penalltinë e parë për ekipin e tij, 1-2, me pas Ekuban ka shënuar për Partizanin 1-3. Me pas ka qenë serish Hoxha, heroi i kësaj ndeshje ai që ka pritur penalltinë e gjuajtur nga Ramirez duke bërë kështu që Partizani të kualifikohet me tej. Në turin e 3-të eliminator Partizani do të ndeshet e austriaket e Salzburg. Ndeshja e parë luhet në Elbasan Arena me datë 27 korrik, kurse ndeshja e kthimit do të luhet me datë 3 gusht.